



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/Nr. 7113 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 12 pika 12.2 shkronja (c), 40.2 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës - nr. 28/2008), Ligji i Administratës Shtetërore të Kosovës nr. 03/L – 189 neni 32, Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 32, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 1 dhe neni 67 pika 4. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

**VENDIM
PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E KOMPETENCAVE DHE PËRGJEGJËSITË E
ORGANEVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE**

I

Miratohet rregullorja me numër 03/Nr.7113/2012 për organizimin e kompetencave dhe përgjegjësit e organeve të administratës komunale.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës, me këtë rregullore përcaktohet organizimi i brendshëm i administratës së komunës, kompetencat, detyrat dhe përgjegjësit e organeve të administratës në pajtim me dispozitat e ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me pushtetin lokal si dhe dispozitat e statutit të komunës së Hanit të Elezit.

III

Rregullorja është hartuar nga drejtoria për administratë, përmban gjithsej 16 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi

